



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

Nr. 141 Regj.Them.

Datë Regjistrimi 29/09/2017

Data e Vendimit 30/10/2017

V E N D I M  
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga

GJYQTAR : ARDIAN KALIA

asistuar nga sekretare gjyqësore Beglie NURA, në seancë gjyqësore me dyer te hapura, sot me datë 30/10/2017, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga Prokuror Ylli PJETERNIKAJ, përfundoi shqyrtimin, e kërkesës penale, e cila i përket:

Kërkues: Y. D., i biri i H. dhe i M., i dtl.25/10/19.., lindur ne Tirane dhe banues ne Detroid Miçigan ..., Kodi postar Nr. ..., me gjendje civile beqar, me kombësi shqiptare dhe shtetësi amerikane, i përfaqësuar në gjykim nga Av.Liljana GJOMEMA, me Nr. Liçense 4234 dhe NIPT L61904022E, Anëtare e Dhomës së Avokatëve Tiranë.

Objekti: Kundërshtimi i vendimit të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë i datës 21/09/2017, për sekuestrimin e provave materiale të depozituara në llogari rrjedhëse edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, në emër të shtetasit Y. H. D., pranë Bankës Raiffeisen.

Baza Ligjore: Neni 212 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi verifikoi kryesisht juridiksionin e kompetencën për shqyrtimin e kësaj kërkesë, dëgjoi palët në diskutimin përfundimtar, të cilët kërkuan respektivisht: Kërkuesi dhe mbrojtësja e tij – Pranimin e kërkesës; Prokuror Ylli PJETERNIKAJ – Rrëzimin e kërkesës; dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Se Kërkuesi Y. D. ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt dhe referencë ligjore si më lart, kërkesë e cila është regjistruar nga K.Sekretaria gjyqësore e asaj Gjykate në dt.29/09/2017.

2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë, rezultoi e provuar se, në datë 21:09:2017, është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë referimi penal nr 12466 prot datë 21.09.2017 nga policia gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Seksioni për Hetimin dhe Pastrimin e Parave. Në këtë referim oficeri i policisë gjyqësore

deklaron se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave, me anë të shkresës me Nr.1196/9, datë 19.09.2017, ka lëshuar urdhërin me Nr.101, për banken e nivelit të dytë që operon në vendin tonë, Banka “RAIFFEISEN”, për bllokim të përkohshëm të transaksioneve dhe llogarive si dhe gjendjes që ato kanë në llogari të shtetasit Y. H. D. i datëlindjes 25.10.19...

3. Nga aktet e hetimeve paraprake të deritanishme në lidhje me procedimin e mësipërm penale, rezultojnë të provuara faktet e rrethanat që vijojnë:

4. Shtetasi amerikan M. J. T., i shoqëruar nga shtetasi Y. D., janë paraqitur në bankën Raiffeisen në datën 05.09.2017, për të hapur një llogari bankare rrjedhëse. Shtetasi M. T. ka deklaruar se do të transferonte nga llogaria e tij personale në USA, përkatësisht shumën prej 500.000 USD. Këto fonde do të transferoheshin për në Shqipëri pasi ai ishte interesuar të investojë në disa lloj biznesesh në Shqipëri si: telekomunikacion, prodhim, peshkim, ndërtime, tendera, etj. Në datën 06.09.2017, rezulton të jetë transferuar në këtë llogari shuma prej 499,826 USD dhe shtetasi M. T., më pas e ka transferuar në llogarinë e shtetasit Y. D.. Qëllimi i transfertës, sipas sa përkshruhet në aktin përkatës, ka të bëjë me dhënie borxhi pa interes me një afat kthimi 12 muaj e cila verifikohet përmes një deklarate noteriale (nr kol ...), të nëshkruar mes palëve në datë 5.9.2017, tek notere Ardjana MEDIU Tiranë.

5. Nga verifikimet e kryera nga ana e organit të Prokurorisë, në llogarinë e mësipërme bankare pranë bankës Raiffeisen Bank sh.a, në Tiranë, rezulton se, shtetasi Y. D. ka kryer këto veprime bankare:

Ka kryer dy tërheqje cash në datat 11.9.2017 në shumën 15,000 USD dhe në datë 12.9.2017 në shumën 50,000 USD.

Përveç sa më sipër ai ka deklaruar se do të kryejë një investim duke blerë një anije nga shtetasi A. M.A. M. i datëlindjes 26.03.1983. Vlera për shitjen e Anijes është 500.000 USD, sipas deklaratës noteriale të nëshkruar nga shtetasi A. M..

6. Nga verifikimet e kryera nga ana e organit të Prokurorisë, në lidhje me shtetasin A. M., sipas përfaqësuesit të Prokurorisë, kanë rezultuar raportime financiare në lidhje me këtë person, sikundër vijon:

Në datë 08.03.2016, ka lidhur një kontratë porosie për një apartament me çmim 72,500 Euro, nga të cilat janë likujduar: ‘me këste: kesti i 1 - 22.500 Euro në momentin e nëshkrimit të kontratës; nëpërmjet bankës kesti i 2 - 50.000 Euro likujdohet deri në fund të korrikut 2016’. Shoqëria ndërtuese me të cilën është lidhur kontrata është “XH...” Shpk, me nipt K8...7A.

Në datë 11.04.2013 ka një deklaram nga ana e shtetases Xh. A. M. për një detyrim ndaj shtetasit A. S. M. prej 9,000 Euro, me përshkrimin se ‘shuma do të shlyhet brenda datës 01.08.2013 dhe në rast të kundërt deklaruesja Xh. M. ka detyrimin e kalimit në favor të deklaruesit A. M. të një autoveture tip BMW me targa italiane D...R’.

7. Gjithashtu, sipas Prokurorisë, nga verifikimet e deritanishme u provua prania e disa raportimeve lidhur me transaksione bankare, të kryera në emër të shtetasit A. M. si individ. Më konkretisht, ky shtetas është arrestuar në 2013, i akuzuar për kontrabandim nafte dhe është dënuar në Maj 2015 për këte vepër penale.

8. Duke u bazuar në faktet e mësipërme, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vlerësuar se, nisur nga prania e dyshimeve për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, kjo referuar aktivitetit të shtetasve M. T. dhe Y. D., lidhjeve të tyre me shtetasin A. M., burimit të këtyre fondeve si dhe nisur nga fakti se blerja e anijes është deklaruar se do të realizohej nga shtetasi i huaj T., ndërsa fondet janë transferuar të gjitha tek shtetasi Y. D., i cili ka deklaruar se ai do investojë në blerjen e një anijeje.

9. Bazuar në ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në lidhje me sa sipër, nga ana e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë, është disponuar me vendimin e datës 21/09/2017 duke disponuar: “Sekuestrimin në cilësinë e proves materiale, të shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë në emër e për llogari të shtetasit Y. H. D., i datëlindjes 25.10.19..., pranë “Bankës Raiffeisen”.

10. Kundër këtij vendimi, është ushtruar ankim nga ana e shtetasit Y. D., pasi ka marrë dijeni në lidhje me përmbajtjen e tij. Nga përmbajtja e tekstit integral të ankimit dhe nga gjatë parashtrimeve të bëra nga ana e mbrojtëses së ankuesit, gjatë shqyrtimit gjyqësor, u parashtrua se, vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë i sekuestrimit dt.21/09/2017, vjen ndesh me ligjin procedural penal dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

11. Nga ana e përfaqësueses së ankuesi u pretendua se, ndryshe nga se, vendimi i Prokurorit për marrjen e masës së sekuestros, është marrë në shkelje të dispozitave të ligjit procedural penal, pasi nuk i është komunikuar ligjërisht ankuesit, duke shkelur të drejtat e tij pasurore. Sipas përfaqësueset të ankuesit, vendimi i Prokurorisë për sekuestrimin e mjeteve monetare, është në kundërshtim me ligjin pasi, vlerat monetare të transferuara nuk burojnë nga aktivitete kriminale dhe subjekti i cili i ka transferuar ato, shtetasi amerikan M. T., ushtron në SHBA një aktivitet të ligjshëm tregtar nga i cili i vijnë fitime të konsiderueshme vjetore. Mbrojtësja pretendoi se, shumat e parave të transferuara vjen nga burime të ligjshme financimi dhe nuk ka lidhje me asnjë aktivitet kriminal.

12. Përfaqësuesja e ankuesit pretendoi gjithashtu se, nga ana e Prokurorisë nuk u paraqit asnjë provë që të vërtetonte se, ankuesi kishte marrë pjesë në ndonjë veprimtari kriminale e cila mund të prodhonte para dhe në këtë kuptim, bie akuza për pastrim të produkteve të veprës penale për të cilën organi i Prokurorisë ngre dyshime ndaj ankuesit pasi, sipas përfaqësueses së këtij të fundit, argumentet e prokurorisë bazohen thjesht në supozime dhe informacione apo indicie të cilat nuk kanë vlerën e provës.

13. Në përfundim, mbrojtësja e ankuesit dhe vetë ankuesi, i kërkuan gjykatës, shfuqizimin e vendimit të sekuestrimit të datës 21/09/2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lirim të menjëhershëm të vlerave monetare të sekuestruara.

14. Nga ana e tij, Prokurori Ylli PJETËRNIKAJ i kërkoi Gjykatës rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të sekuestrimit të vlerave monetare, i datës 21/09/2017. Sipas tij, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për marrjen e kësaj mase në këtë fazë të hetimeve. Nga ana e Prokurorit u parashtrua veç të tjerash sa vijon:

Sekuestrimi si mjet i kërkimit të provave është parashikuar nga nenet 208 – 220 të K.Pr.Penale, në këto dispozita është parashikuar objekti i sekuestrimit, subjektet që disponojnë për kryerjen e sekuestrimit, të drejtat e palëve në këtë proces, mënyra e kryerjes së sekuestrimit si dhe ruajtja, administrimi i sendeve e objekteve të sekuestruara. Sekuestrimi në vetvete nënkupton marrjen ose vënien në administrim të sendeve, të objekteve apo të dokumenteve, nga ana e organit procedues, të cilat vlerësohen se shërbejnë si prova në procesin penal apo lidhen me procesin e të provuarit. Ligjshmeria e sekuestrimit si mjet për kërkimin e provës kërkon plotësimin në mënyrë komulative të disa kushteve të sanksionuara nga ligji procedural penal, të cilat ndahen në kusht të përgjithshëm dhe kushte të posaçme. Ekzistenca e figurës së veprës penale, në funksion të provueshmërisë të së cilës shërben sekuestrimi si mjet për kërkimin e provës është kushti i përgjithshëm. Legjislacioni procedural penal e lidh sekuestrimin me ekzistencën e figurës së veprës penale. Në vlerësimin e këtij kushti duhet mbajtur parasysh faza fillestare, që paraprin procedimin penal, fazë në të cilën niveli apo standarti i provueshmërisë nuk është tej çdo dyshimi të arsyeshëm, madje një standart të tillë nuk e kërkon ligji. Ky i fundit, kërkon që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për ekzistencën e figurës së veprës penale. Analiza e këtij koncepti duhet të bëhet në ngjashëri me konceptin e dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në prova për caktimin e masës së sigurimit. Koncepti i dyshimit të arsyeshëm mbështetet në konceptin filozofik mbi të vërtetën dhe në parimin juridik të prezumimit të pafajësisë. Zbulimi i së vërtetës është një proces kompleks që realizohet gradualisht në bazë të shkallës së njohjes dhe të provave që e argumentojnë atë. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova konsiston në krijimin e besimit në formën e probabilitetit apo mundësisë për ekzistencën e veprës penale dhe përgjegjësisë së të dyshuarit. Kjo bindje nuk është në nivelin e asaj që kërkohet për shqyrtimin gjyqësor mbi ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale. Një standard i tillë (dyshimi i arsyeshëm) zvogëlon mundësinë e përdorimit të këtij mjete për kërkimin provës dhe shfaqet si garantuese e mbrojtëse e lirisë dhe të drejtave të të dyshuarit. Kushti i ekzistencës së provave, mbi të cilat krijohet dyshimi përbën thelbin e dyshimit të arsyeshëm. Janë të mjaftueshme dyshimet e bazuara në nivelin e arsyes, të pranueshme nga njeriu me një logjikë normale që gjykon paanshmërisht. Nuk kërkohet bindje. Kjo do të thotë që veprimtaria provuese vazhdon. Në këtë kontekst, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së nuk kërkohet një nivel i lartë i të provuarit sipas standardit të dyshimit të arsyeshëm. Mjafton, sipas GJEDNJ,

që dyshimi i arsyeshëm duhet të jetë i sigurtë dhe në mirëbesim. Standardi i të provuarit "Dyshimi i arsyeshëm", i referuar në Nenin 5/1(c) të KEDNJ-së, që një veprë penale është kryer, presupozon ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë penale. Pra, i kushtohet rëndësi mundësisë se është kryer veprë penale dhe jo sigurisë se plotë se është kryer. GJEDNJ ka vënë në dukje kriteret të cilat përcaktojnë kuptimin e standardit të dyshimi të arsyeshëm: Të ekzistojnë fakte ose informacione që ekziston figura e veprës penale. Këto fakte dhe informacione të krijojnë bindjen tek një vëzhgues objektiv, Dyshimi të jetë i arsyeshëm”.

15. Sipas Prokurorit, në rastin konkret të tre kriteret e përmendura me sipër lidhur me dyshimin e arsyeshëm për ekzistencën e figures së veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” ekzistojnë, ndaj vendimi i sekuestrimit të datës 21/09/2017, duhet lënë në fuqi si i mbështetur ligjërisht e në prova.

16. **LIGJI I APLIKUESHEM**

Neni 208 i K.Pr.Penale

“1.Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm”.

Neni 210 i K.Pr.Penale

1. Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori”.

**VLERËSIMI I GJYKATËS**

17. Nga shqyrtimi i pretendimeve dhe prapsimeve të parashtruara në gjykim nga palët ndërgjyqëse, nga shqyrtimi i akteve shkresore provuese të paraqitura nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë, në interpretim të dispozitave të legjislacionit procedural penal të cilat, dispijnojnë masat e përkohshme në procesin penal, specifikuisht sekuestrimet si mjet për kërkimin e provës, duke përfshirë dhe sekuestrimet pranë bankave, Gjykata vlerëson se, pretendimet e parashtruara nga ana e ankuesit dhe mbrojtjes së tij, janë të pambështetura ligjërisht ndaj kërkesa ankimore duhet rrëzuar.

18. Duke e trajtuar masën e sekuestrimit të marrë nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë, me dt.21/09/2017, në vështrim të dispozitave të neneve 208 e 210 të K.Pr.Penal, si dhe mbështetur në parimet e përgjithshme të ligjit procedural penal të Republikës së Shqipërisë, Gjykata vlerëson se, nga tërësia e akteve të paraqitura në cilësinë e provës nga

ana e përfaqësuesit të akuzës, provohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, si premisë me të cilën, ligji procedural penal, lidh mundësinë e marrjes së masës së sekuestros.

19. Në një konkluzion të tillë, Gjykata arrin duke iu referuar faktit të provuar sikundër më lart, tekstit në kontratës së huasë, pranisë së disa rrethanave që lidhen me veprimtari të jashtëligjshme të personave të përfshirë në këto transaksione, mungesës së dokumentacionit ligjor nga ana e subjektit transferues të vlerave nga SHBA, për të justifikuar ligjërisht origjinën e vlerave monetare.

20. Në përfundim, duke e trajtuar masën e sekuestros të marrë nga ana e Prokurorisë si masë të përkohshme dhe në funksion të një procedimi penal, njëherazi të mbështetur ligjërisht për sa është disponuar në vendimin e datës 21/09/2017, Gjykata çmon të disponojë me rrëzimin e kërkesës ankimore të parashtruar nga ana e ankuesit Y. D..

#### PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 112, 208, 210, 212 të K.Pr.Penale

#### VENDOSI

- I.** Rrëzimin e kërkesës.
- II.** Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen Ankuesit.
- III.** Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
  - U shpall në Tiranë sot, me dt.30/10/2017.

SEKRETARE  
BEGLIE NURA

GJYQTAR  
ARDIAN KALIA